



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 189, Datë 06.06.2023

MBI

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË”
SH.A., NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2 gërma “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e”, si dhe neneve 13 dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.06.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 999/8 prot., datë 01.06.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Rinovimin e licencës së shoqërisë “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 198, datë 03.09.2018”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” (FTL) sh.a, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 999 prot., datë 03.03.2023, aplikoi për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe me vendimin nr. 77, datë 15.03.2023, bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për kërkesën e protokolluar në ERE.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.03.2023 dhe 17.03.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.03.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 122, datë 04.04.2023 vendosi të zgjasë me 20 ditë vendimarrjen e bordit në lidhje me aplikimin e shoqërisë “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” sh.a. me qëllim plotësimin e dokumentacionit të munguar nga ana e shoqërisë, ndërsa me vendimin nr. 143, datë 24.04.2023, u vendos shtyrja me 30 (tridhjetë) ditë pune e vendimarrjes përfundimtare të bordit të ERE-s me qëllim saktësimin/sqarimin e dokumentacionit financiar. Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin

e plotësuar të aplikimit, sipas Shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur).

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “FTL” sh.a. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin si vijon:
 - Neni 16, gërma “a” Plotësuar
 - Neni 16, gërma “b” Plotësuar
 - Neni 16, gërma “c” Plotësuar
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të rinovojë licencën e shoqërisë “FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË” sh.a., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 04.09.2023.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

Petrit AHMETI